



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIM

Nr. 234 Akti

Nr. 295 Vendimi  
Tiranë, më 16.9.2020

**V E N D I M**

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessing, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datat 19.6.2020, 2.7.2020 dhe 14.9.2020, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Moisi Duda**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Moisi Duda, si dhe bisedoi çështjen në tërësi.

**V Ë R E N:**

1. Z. Moisi Duda është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Apelit Durrës, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Z. Moisi Duda, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.11.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Xhensila Pine – relatores.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në

vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak vetem për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Moisi Duda; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për të kërkuar marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarit; si dhe (v) afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Përmes postës elektronike të datës 27.4.2020, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit, se afati 10 ditor, do fillonte nga e nesërmeja e heqjes së pezullimit përcaktuar në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19."

7. Me hyrjen në fuqi të Aktit Normativ nr. 21, miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 27.5.2020, trupi gjykues e njoftoi subjektin se afati ishte deri në datën 11.6.2020.

8. Në datën 11.6.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda ka depozituar shpjegimet dhe provat të cilat janë administruar dhe analizuar nga trupi gjykues.

9. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, për komponentin e pasurisë, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, në datën. 19.6.2020, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

10. Trupi gjykues, pas zhvillimit të seancës dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Moisi Duda, seancë në të cilën subjekti u përfaqësua nga mbrojtësi i tij ligjor, pajisur me prokurë, vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore duke ftuar personalisht subjektin për disa çështje rezultuar nga hetimi administrativ. Për këtë qëllim, trupi gjykues njoftoi subjektin se seanca e radhës do të ishte në datën 2.7.2020, ora 10:15, në Pallatin e Koncerteve.

11. Në vijim subjekti paraqiti me postën elektronike të datës 7.7.2020, dokumentacionin<sup>1</sup> e plotë bashkë me historikun e regjistrimit të pasurisë apartament me sip. 23 m<sup>2</sup>.

12. Në datën 9.7.2020, trupi gjykues, pasi u njoh me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti lidhur me kriterin e pasurisë, vendosi të rihapë hetimin kryesisht për vlerësimin e pasurisë, si dhe të hapë hetimin kryesisht për dy kriteret e tjera, vlerësimit të figurës dhe atij profesional.

13. Në datën 3.9.2020, subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi përfundimin e hetimit shtesë lidhur me kriterin e pasurisë, si edhe përfundimin e hetimit lidhur me dy kriteret e tjera, dhe mbi të drejtën e njohjes me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, lidhur me hetimin shtesë kriterin e pasurisë, dhe hetimin lidhur me dy kriteret e tjera, si dhe të drejtat procedurale, afati i ushtrimit të të cilave ishte deri në datën 9.9.2020.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\*\*\* prot., datë 6.7.2020, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Lushnjë.

14. Në datën 4.9.2020<sup>2</sup>, nëpërmjet postës elektronike u njoftua mbi sa më sipër.
15. Në datën 9.9.2020, subjekti paraqiti shpjegimet e tij shtesë dhe provat<sup>3</sup> mbi to.
16. Trupi gjykues, pas administrimit të tyre vendosi ta ftojë në seancë dëgjimore në datën 14.9.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## II. SEANCA DËGJIMORE

17. Në datat 19.06.2020, 02.07.2020 dhe 14.09.2020, u zhvillua seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit, z. Moisi Duda, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
18. Në përfundim të seancës dëgjimore, te datës 14.9.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, kërkoi konfirmimin në detyrë.
19. Seanca e datës 14.9.2020 u ndërpre, për të vazhduar në 16.9.2020 me shpalljen e vendimit.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

#### A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), si organ ndihmës i Komisionit, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Moisi Duda. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit, z. Moisi Duda ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

21. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe faktet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve financiare parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

**22. Apartament me sip. 108.5 m<sup>2</sup>**, në katin e pestë të pallatit me adresë: Lagjja “Xh. N”, Lushnjë. Vlera: 4.177.250 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i të ardhurave: të ardhurat e kursyera nga pagat dhe interesat e depozitave në Bankën e Shqipërisë.

22.1 Ky apartament është deklaruar subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, me përshkrimin “Apartament banimi, në lagjen ‘Xh. N’, Lushnjë, blerë sipas kontratës datë 30.12.2014 e aktmarrëveshje datë 26.4.2014”

22.2 Lidhur me këtë pasuri në datën 26.4.2014 midis shtetasve E.M dhe A. M dhe Moisi Duda, A. Gj dhe P. A është lidhur aktmarrëveshja me objekt ndërtimin e një kati shtesë mbi godinën 4-katëshe, ndodhur në lagjen “Xh. N”.

<sup>2</sup> Prova të cilat iu ridërguan përsëri në datën 8.9.2020 nëpërmjet postës elektronike.

<sup>3</sup> Vendim me nr. \*\*\*\*, datë 6.3.2019, i Gjykatës së Apelit Durrës me praktikën bashkëlidhur.

22.3 Në datën 30.12.2014 është lidhur kontrata e shitblerjes ku shtetasi E. M, në cilësinë e pronarit të apartamentit me sip. 108.5 m<sup>2</sup>, vërtetuar me vërtetim nga dokumentet hipotekore datë 30.12.2014, i kalon pronësinë e apartamentit, subjektit të rivlerësimit.

22.4 Komisioni, pasi administroi këtë dokumentacion, konstatoi se në dosje nuk ndodhet asnjë akt zyrtar lëshuar nga organi kompetent, Bashkia Lushnjë, për lejimin e kalimit të të drejtave nga shtetasi E dhe Y. M, te subjekti dhe dy shtetasit e tjerë.

22.5 Në pyetësorin e tretë, datë 20.1.2020, Komisioni ka pyetur subjektin nëse ka një miratim nga Bashkia Lushnjë, për kryerjen e investimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22.6 Në përgjigje të pyetësorit të tretë, datë 26.1.2020, subjekti është shprehur: *“Unë nuk kam marrë miratim nga Bashkia Lushnjë për kryerjen e investimit. Nuk kam qenë në dijeni të kërkesës ligjore për një miratim të tillë nga bashkia.”*

22.7 Lidhur me burimet e krijimit për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se ka përdorur si burim shumën prej 3.250.000 lekësh *cash* në shtëpi deklaruar më parë, dhe likuiditete bankare në shumën 1.200.000 lekë tërhequr nga llogaria në “S.G. A”, dega Lushnjë.

### **Lidhur me burimin e deklaruar nga gjendja *cash***

22.8 Lidhur me kursimet *cash* në shumën 3.250.000 lekë, Komisioni verifikoi DPV-të referuese të subjektit ku subjekti ka deklaruar gjendje *cash* fund të vitit, si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash në shtëpi të siguruara nga të ardhurat vjetore në shumën 1.100.000 lekë.”*

- Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash në shtëpi të siguruara nga të ardhurat vjetore në shumën 1.100.000 lekë.”*

- Në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash në shtëpi të siguruara nga të ardhurat vjetore në shumën 1.050.000 lekë.”*

22.9 Komisioni kreu analizën financiare për gjendjen *cash* deklaruar për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Analiza financiare për gjendjen <i>cash</i> të deklaruar në DPV	2011	2012	2013
<b>PASURI</b>	<b>1,080,548</b>	<b>1,221,950</b>	<b>1,175,337</b>
Ndryshim likuiditeti	1,080,548	1,221,950	1,175,337
Total likuiditete deklaruar	7,393,390	8,615,340	9,790,677
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>1,080,548</b>	<b>1,221,950</b>	<b>1,175,337</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,989,880</b>	<b>1,969,878</b>	<b>1,979,699</b>
Të ardhura subjekti nga paga	1,310,206	1,269,894	1,295,464
Të ardhura bashkëshortja nga paga	486,930	506,378	510,589
Të ardhura nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit	192,744	193,606	173,646
<b>SHPENZIME</b>	<b>813,668</b>	<b>558,192</b>	<b>628,646</b>
Shpenzime jetike	546,480	558,192	564,096
Shpenzime për shkollimin e vajzave H. D. dhe I. D.	48,000		
Shpenzime udhëtimi Moisi Duda	80,888	0	11,270
Shpenzime udhëtimi A. D	69,150	0	53,280
Shpenzime udhëtimi H. D	34,575	0	0
Shpenzime udhëtimi I. D	34,575	0	0
Analiza dokumentuar	95,664	189,736	175,716

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka pasur mundësi financiare të krijojë kursimet *cash* të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

### **Lidhur me burimin nga likuiditete tërhequr nga llogaria në “S. G. A”**

22.10 Lidhur me burimin tjetër likuiditete bankare, në deklarinimin periodik të vitit 2014 subjekti deklaron tërhequr nga llogaria në “S. G. A”, dega Lushnjë. likuiditete bankare në shumën prej 1.200.000 lekësh

22.11 Komisioni verifikoi lëvizjet<sup>4</sup> e llogarive bankare në “S.G.A” (sot OTP Bank), ku konfirmohet se subjekti ka tërhequr shumën prej 1.200.000 lekësh: në datën 11.8.2014 shumën 600.000 lekë dhe në datën 14.11.2014 shumën 600.000 lekë.

22.12 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka pasur mundësi financiare të përdorë burimin likuiditete bankare tërhequr nga llogaria në “S.G.A” dhe deklarimi i tij përputhet me rezultatet e hetimit.

### **Lidhur me çmimin dhe pagesën e tij**

22.13 Aktmarrëveshja e datës 26.4.2014 (nenet 2,3 dhe 4), parashikonte se: *“Çmimi do të paguhet në tre këste. Kësti i parë prej 50 % të shumës do paguhet në momentin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshje. Kësti i dytë prej 40 % të shumës do paguhet në momentin e përfundimit të objektit sipas lejes së ndërtimit. Kësti i tretë dhe i fundit 10 % të shumës do paguhet me regjistrimin në ZVRPP dhe nënshkrimit të kontratës së shitjes.”*

22.14 Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*\*, datë 30.12.2014, parashikonte se: *“Çmimi është përcaktuar me marrëveshje midis palëve të likuidohet sipas aktmarrëveshjes, datë 26.4.2014, si dhe mandatarkëtimit, datë 2.5.2014 dhe datë 12.12.2014 pranë ‘R. B’, dega Lushnjë, bashkëlidhur kësaj kontrate.”*

22.15 Komisioni verifikoi çmimet referencë të shitblerjes për vitin 2014 sipas Entit Kombëtar të Banesave në Lushnjë, nga ku rezultoi se çmimi i shitblerjes ka qenë 38.500 lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzim e përafërt me vlerën e deklaruar nga palët.

22.16 Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014 se shuma prej 1.627.300 lekësh është paguar palës shitëse në R.B në datën 2.5.2014, vlera 6.000 euro dhe më 12.12.2014 – vlera 5.000 euro, ndërsa 600 euro paguar me lekë në dorë shitësit.

22.17 Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit të dytë, datë 18.12.2019, ka sqaruar: *“Shuma e parave prej 2.550.000 lekësh i është dhënë dorazi nga ana ime z. Y.M. Këto para ai i ka paguar nëpërmjet ‘R.B’, firmës ‘Ll’ sh.p.k., sipas vërtetimit bankar datë 7.1.2019.”*

Komisioni kreu analizën financiare, si vijon:

Analiza financiare për apartamentin me sip. 108.5 m <sup>2</sup> dhjetor 2014	2014
<b>PASURI</b>	<b>3 783 900</b>
Apartament me sip. 108.5 m <sup>2</sup> “Kongresi i Lushnjës”	4 177 250
Ndryshim likuiditeti	-393 350
Total likuiditete deklaruar	9 397 327
<b>DETYRIME</b>	<b>2 634 170*</b>
Detyrim i papaguar ndaj shitësit E.M	2 634 170
<b>PASURI NETO</b>	<b>1 149 730</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1 941 172</b>

<sup>4</sup> Shkresë nr. \*\*\* tbo-\*\*\* prot., datë 24.12.2019, e OTP Bank.

Të ardhura subjekti nga paga	1 342 355
Të ardhura bashkëshortja nga paga	556 203
Të ardhura shpërblim dhënë nga Bashkia Lushnjë për vajzën H. D.	27 000
Të ardhura nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit	15 614
<b>SHPENZIME</b>	<b>769 494</b>
Shpenzime jetike.	714 994
Shpenzime për shkollimin e vajzës H. D.,ne Universitetin e Tiranës	54 500
<b>Rezultati financiar</b>	<b>21 948</b>

22.18 Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare për investimin në pasurinë e paluajtshme me balancë pozitive prej 21.948 lekësh.

**22.19 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për lidhjen e marrëveshjes në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi lidhur me lejen e ndërtimit.**

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

22.20 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “ Unë dua të sqaroj edhe njëherë se kjo marrëveshje është lidhur me vullnetin e plotë të të gjitha palëve dhe se unë nuk kam qenë në dijeni të kërkesës ligjore për miratimin e kësaj marrëveshjeje nga bashkia. “

**Analiza e fakteve dhe e ligjit te zbatueshëm**

22.21 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka deklaruar saktë burimet e krijimit për këtë pasuri, ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj, por nuk ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi për lejin e kalimit të të drejtave për lejen e ndërtimit .

**23. Autoveturë tip “V. P”** përfitur me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 3.12.2015. Vlera e blerjes 50.000 lekë dhe vlera e rregullimit 30.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat e kursyera nga paga.

23.1 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga Komisioni për sa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë dhe çmimit të blerjes së automjetit.

23.2 Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësinë financiare të blerjes së automjetit, si vijon:

<b>Analiza financiare për blerjen e automjetit 3 dhjetor 2015</b>	<b>3.12.2015</b>
<b>PASURI</b>	<b>-177,895</b>
Autoveturë blerë me kontratën nr. ****, datë 3.12.2015	50,000
Ndryshim likuiditeti	-227,895
Total likuiditete deklaruar	5,919,432
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>-177,895</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,883,601</b>
Të ardhura subjekti nga paga	1,353,977
Të ardhura bashkëshortja nga paga	513,667
Të ardhura nga interesat e bonove të thesarit	15,957
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,864,054</b>
Shpenzime jetike.	659,332
Shpenzime për mobilimin e apartamentit.	830,000

Shpenzime për shkollimin e vajzës H. D. në Universitetin e Tiranës	231,917
Shpenzim për riparimin e mjetit blerë më 3.12.2015	35,000
Shpenzim për vendosje paneli diellor	80,000
Shpenzime udhëtimi Moisi Duda	10,598
Shpenzime udhëtimi A.D	6,883
Shpenzime udhëtimi H. D	6,883
Shpenzime udhëtimi I. D	3,441
<b>Rezultati financiar</b>	<b>197,443</b>

23.3 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e kësaj pasurie në vlerën 50.000 lekë.

#### **24. Të ardhura të depozituara në Bankën Amerikane të Investimeve**

24.1 Këto të ardhura janë deklaruar se janë siguruar ndër të tjera nga: (i) heqja dorë nga e drejta e tij e pronësisë për tokë dhe shtëpi në fshat prej 40 m<sup>2</sup> pjesë takuese të tij sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”; (ii) shitja e një sip. 23 m<sup>2</sup>; (iii) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “D. C”.

#### **Në lidhje me burimin të ardhurat e siguruara nga heqja dorë nga e drejta e pronësisë së tokës dhe pjesës së shtëpisë në fshat me sip. 40 m<sup>2</sup>**

24.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar tokë bujqësore dhe shtëpi banimi me sip. 40 m<sup>2</sup>, në B i V, Lushnjë. Burim krijimi: ligji nr. 7501, “Për tokën”.

24.3 Nga akti i marrjes së tokës në pronësi nr. \*\*\* regj., datë 25.3.1993, me ligjin nr. 7501, familjes së subjektit, B i V, i është dhënë në pronësi gjithsej tokë me sip. 20800 m<sup>2</sup>.

24.4 Ato janë regjistruar në datën 25.6.1995, në z. k. \*\*\*, në pronësi të kryefamiljarit shtetasit K.D, si përfaqësues i familjes bujqësore.

24.5 Nga vlerësimi i dokumentacionit toka bujqësore në emër të babait të subjektit nuk evidentohet te kete pasur ndarje apo pjestime midis familjarëve.

24.6 Subjekti ka deklaruar: “Shtëpia në fshat me sip. 92 m<sup>2</sup> është ndërtuar në vitet 1994-1995 me kontributin e përbashkët të prindërve, familjes së vëllait dhe timin dhe është e regjistruar në vitin 1995 në emër të babait”.

24.7 Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me: të drejtat e tij në shtëpinë e banimit me sip. 40 m<sup>2</sup> në fshatin B i V, Lushnjë; vlerën e investimit; kontributin përkatës.

24.8 Subjekti ka sqaruar se: “Nuk e përcaktoj dot se sa ka qenë kontributi im, por ky kontribut ka qenë në raport me të ardhurat nga paga që merrja. Kontributi im ka qenë gjatë kohës së ndërtimit të shtëpisë i cili ka zgjatur rreth 2 vjet,”

24.9 Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga heqja dorë e pronësisë mbi tokën bujqësore dhe shtëpinë sipas marrëveshjes me të vëllanë, sipas së cilës shkëmbeu të drejtat e tij në tokën dhe shtëpinë në fshat me shtëpinë që i vëllai kishte në Lushnjë nga viti 1996.

24.10 Subjekti ka sqaruar se: “Marrëveshja që kam bërë me të vëllanë ka qenë një marrëveshje shkëmbimi. Unë këtë fakt e kam theksuar edhe më parë. Marrëveshja u arrit jo vetëm me vullnetin tonë, por edhe me insistimin e prindërve”.

24.11 Vëllai i subjektit M. D, kishte në pronësi prej vitesh një apartament në Lushnjë të cilin e shiti në vitin 2004, në çmimin 1.500.000 lekë.



24.12 Shumën e parave që iu pagua vëllait nga blerësi P. K, iu la subjektit në këmbim të heqjes dorë të tij nga e drejta e pronësisë së tokës dhe shtëpisë në fshat.

24.13 Ky fakt gjen pasqyrim edhe në deklarin periodik të vitit 2004 të subjektit të rivlerësimit ku deklarohet kjo shumë si burim krijimi për likuiditetet e vendosura në bankë.

24.14 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa nuk ka akt provues, lidhur me marrëdhënien me të vëllanë, për shkëmbimin dhe përfitimin e të ardhurave në shumën 1.500.000 lekë.

### **Në lidhje me burimin të ardhurat e siguruar nga shitja e një sipërfaqeje prej 23 m<sup>2</sup>**

24.15 Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 të ardhura nga shitja e sip. 23 m<sup>2</sup> në vlerën 1.200.000 lekë, sipas kontratës me nr. \*\*\*\*\*, datë 27.11.2004.

24.16 Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*\*\*, datë 27.11.2004, midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit P.K, me objekt kalimin e pronësisë së pasurisë apartament me sip. 23 m<sup>2</sup> ka përcaktuar në çmimin në vlerën 1.200.000 lekë,

24.17 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për ligjshmërinë e të ardhurave të siguruar nga shitja e sipërfaqes prej 23 m<sup>2</sup> shitur në vlerën 1.200.000 lekë në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

24.18 Analiza financiare e përgatitur në rezultate hetimi për mundësinë e investimit në bono thesari, pa u konsideruar e llogaritur në të vlerat e përfituara nga shitja e ndërtesës me sip. 23 m<sup>2</sup> dhe pa konsideruar e llogaritur në të vlerat e përfituara nga shkëmbimi i tokës dhe banesës në fshat, për të cilat iu kalua barra e provës, të provojë të kundërtën, rezultoi si vijon:

Investim në bono thesari, datë 17.1.2005,	<b>17.1.2005</b>
<b>PASURI</b>	<b>2,654,726</b>
Likuiditete	2,654,726
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>2,654,726</b>
<b>TË ARDHURA 1.1.2005 – 17.1.2005</b>	<b>51,734</b>
<b>Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 23 m<sup>2</sup></b>	<b>0</b>
<b>Të ardhura nga pjesa takuese e tokës bujqësore e banesës në fshat</b>	<b>0</b>
Të ardhura subjekti nga paga	33,629
Të ardhura bashkëshortja nga paga	18,105
<b>SHPENZIME</b>	<b>54,779</b>
Shpenzime jetike.	54,779
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-2,652,191</b>

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

24.19 Subjekti, në shpjegimet e tij, sqaron: “Në lidhje me mungesën e marrëveshjes ligjore me të vëllanë tim M. D për shkëmbimin e shtëpisë që ai kishte blerë në qytetin e Lushnjës, shtëpi në të cilën unë banoja, me pjesën takuese tokë dhe shtëpi që kisha në fshatin B i V, Lushnje, dua të sqaroj, ashtu siç kam sqaruar edhe më parë, se ky shkëmbim u bë me marrëveshje verbale, pasi as unë dhe as vëllai nuk kemi pasur de jure pronësinë mbi sipërfaqen e tokës apo shtëpinë në fshat, sepse pronësia ishte dhe është në emër të babait, K. D.



*Një arsye tjetër është edhe fakti që shkëmbimi ishte një marrëdhënie mes vëllezërve, i iniciuar nga prindërit dhe i realizuar me dëshirën tonë të plotë, pa asnjë lloj pretendimi ndaj njërit-tjetrit.*

*Në fund të vitit 2004, unë bashkë me të vëllanë e shitëm shtëpinë. Me shitësin ramë dakord që çmimi i shitjes për të gjithë shtëpinë të ishte 2.700.000 lekë. Veprimi i shitjes është bërë me dy kontrata të ndryshme, përkatësisht me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 27.11.2004, unë kam shitur pjesën time dhe me kontratën nr. \*\*\*\*, datë 27.11.2004, vëllai M.D ka shitur pjesën e vet. ”*

#### **Lidhur me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “D. C”**

24.20 Subjekti ka deklaruar në Deklarimin periodik vjetor te vitit 2016 të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 3.000 euro.

24.21 Komisioni i kërkoi informacion DPSHTRr-së, e cila me shkresën nr. \*\*\* datë 25.2.2019, konfirmon shitjen e këtij automjeti për të njëjtin çmim të deklaruar nga subjekti, me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*\*, datë 27.10.2016.

24.22 Ky automjet është deklaruar nga subjekti për herë të parë në vitin 2010 “blerë në Itali me çmim 3.900 euro, 360.000 lekë zhdoganimi.

24.23 Për sa përputhet deklarimi i subjektit me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, Komisioni i ka konsideruar veprimet e blerjes dhe shitjes së automjetit për efekt të analizës financiare të vitit përkatës.

#### **Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm në lidhje me burimin të ardhura nga heqja dorë nga e drejta e pjesës takuese të subjektit nga pronësia e tokës dhe shtëpisë në fshat**

24.24 Trupi gjykues arsyeton se subjekti referuar ligjit nr. 7501/1991, sipas të cilit anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para datës 19.7.1991, rezulton bashkëpronar në të.

24.25 Në lidhje me të ardhurat e siguruara nga marrëveshja e bërë me të vëllanë, trupi gjykues arsyeton se referuar Kodit Civil që rregullon marrëdhënien ligjore të shkëmbimit në nenet 757 e vijues të tij, palët nuk kanë respektuar dispozitat e marrëdhënies së shkëmbimit me objekt pasuritë e paluajtshme.

24.26 Kjo pasuri nuk u pjesëtua sipas rregullave të Kodit Civil: “*Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1.8.1991, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të këtij kodi për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.*”

24.27 Pavaresisht pasaktësitë ligjore të marrëveshjes ajo dhe përfitimi i këtyre të ardhurave është deklaruar prej subjektit që në deklaratën periodike vjetore 2004 dhe në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, ky deklarim përbën provë per te mbeshtetur pretendimin se kjo shumë është përfituar prej tij.

24.28 Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, vlerëson se pasaktësitë ligjore mbi të cilin bazohet shkëmbimi i pasurive mes subjektit dhe vëllait, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme për mosmarrjen në konsideratë të shumës e cila është përfituar prej tij.

24.29 Nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt që të vërë në dyshim vërtetësinë e kësaj rrethane dhe situatë të shpjeguar nga subjekti, përkundrazi, gjatë hetimit rezultuan prova të tjera që mbështesnin këtë qëndrim të subjektit të rivlerësimit.

24.30 Në këtë kuptim, në lidhje me marrëveshjen mes subjektit dhe vëllait, në cilësinë e bashkëpronarëve me pjesë takuese ideale, si “burim” i shumës 1.500.000 lekë, trupin gjykues arrin në konkluzionin se subjekti arriti të shpjegojë por kjo shumë rezultoi e provuar se është përfituar nga subjekti i rivlerësimit.

24.31 Përveç sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që shuma prej 1.500.000 lekësh, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ishte një shumë për të cilën ishin paguar detyrimet tatimore, për sa kohë u provua regjistrimi në emër të blerësit për shumën e referuar në kontratën e shitblerjes.

24.32 Trupi gjykues nënvizon se subjekti për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve familjare, duhet të kishte treguar një vëmendje të shtuar duke mundësuar formalizimin e marrëveshjeve familjare.

### **Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm në lidhje me burimin të ardhurat e siguruar nga shitja e sipërfaqes prej 23 m<sup>2</sup>**

24.33 Pas rihapjes së hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti depozitoi vërtetimin hipotekor sipas të cilit kjo sipërfaqe ishte regjistruar në emër të blerësit me të njëjtën vlerë të kontratës së shitblerjes së nënshkruar mes palëve.

24.34 Trupi gjykues mban në konsideratë faktin që shuma prej 1.200.000 lekësh, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ishte një shumë për të cilën ishin paguar detyrimet tatimore, për sa kohë u provua regjistrimi në emër të blerësit i pasurisë për shumën e referuar në kontratën e shitblerjes.

24.35 Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, vlerëson se subjekti arriti të provojë të ardhurat e ligjshme përfituar, prej tij nga shitja e sipërfaqes prej 23 m<sup>2</sup>

24.36 Në konkluzion, trupi gjykues, në lidhje me shumën e depozituar në B. A të Investimeve, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës së dërguar nga Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit. Analiza financiare finale për subjektin e rivlerësimit ndryshoi, si vijon:

Investim në bono thesari, datë 17.1.2005	<b>17.1.2005</b>
<b>PASURI</b>	<b>2,654,726</b>
Likuiditete	2,654,726
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>2,654,726</b>
<b>TE ARDHURA 01.01.2005-17.01.2005</b>	<b>2,751,734</b>
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Lushnje me sip. 23 m <sup>2</sup>	<b>1,200,000</b>
Të ardhura nga shkembimi i pjesës takuese të tokës bujqësore e banesës në fshat	<b>1,500,000</b>
Të ardhura Subjekti nga paga	33,629
Te ardhura bashkëshortja nga paga	18,105
<b>SHPENZIME</b>	<b>54,779</b>
Shpenzime jetike.	54,779
<b>Analiza financiare finale për investimin në bono thesari dt 17.01.2005</b>	<b>42,230</b>

24.37 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në bono thesari, në datën 17.1.2005.

### **25. Lidhur me investimin në vlerën prej 3.300.000 lekësh, datë 15.5.2009, të Banka e Shqipërisë**

25.1 Në datën 15.5.2008, bashkëshortja e subjektit, znj. A. D, ka kryer një depozitim *cash* në shumën 31.110 euro në llogarinë e saj në Tirana Bank.

25.2 Në datën 19.5.2008, shuma është investuar në depozitë me afat në emër të bashkëshortes së subjektit dhe më 23.10.2008 shuma 31.465 euro, është tërhequr *cash* prej saj.

25.3 Subjekti, i pyetur lidhur me këtë transaksion, ka sqaruar se: “Në datën 23.10.2008, tërhequr nga depozita në Tirana Bank të gjithë shumën e eurove të depozituara dhe konkretisht shumën prej 31.465 euro. Këtë shumë e kam mbajtur *cash* në banesë. Në datën 13.5.2009, shumën prej 3.300.000 lekësh e kam depozituar ne Bankën e Shqipërisë Lushnjë.”

25.4 Komisioni, me rezultate hetimi përgatiti analizën financiare të vitit 2009, duke mos marrë në konsideratë gjendjen *cash* të padeklaruar në vitin 2008 nga subjekti dhe rezultoi si vijon:

Analiza financiare	<b>2009</b>
<b>PASURI</b>	<b>4 958 107</b>
Ndryshim likuiditeti	4 958 107
Total likuiditete deklaruar	6 628 681
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>4 958 107</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>1 812 340</b>
Të ardhura subjekti nga paga	1 160 926
Të ardhura bashkëshortja nga paga	427 805
Të ardhura deklaruar në deklaratën periodike	139 921
Të ardhura nga interesat e përfituara nga Raiffeisen Bank	33 417
Të ardhura nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit	50 271
<b>SHPENZIME</b>	<b>626 480</b>
Shpenzime jetike	546 480
Shpenzime për shkollimin e vajzave.	80 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-3 772 247</b>

25.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e rezultatit të Komisionit për sa subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të shtojë likuiditetin në shumën 4.958.107 lekë, dhe të përballojë shpenzimet e tjera për vitin 2009, duke rezultuar me rezultat financiar negativ 3.772.247 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

25.6 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shuma prej 26.465 euro ishte e deklaruar si e tërhequr nga banka në vitin 2008 dhe e deklaruar më këtë burim kur është ridepozituar në vitin 2009.

### **Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm**

25.7 Deklarata periodike vjetore në vitin 2008 nuk ka deklarim të shumës tërhequr nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank, si gjendje *cash* në banesë.

25.8 Trupi gjykues vlerësoi të analizojë edhe deklaratën periodike vjetore të subjektit për vitin 2009, ku subjekti deklaroi investimin në vlerën prej 3.300.000 lekësh, datë 15.5.2009, te Banka e Shqipërisë, duke deklaruar burim nga shuma tërhequr në 2008 nga Raiffeisen Bank.

25.9 Komisioni, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i ka njohur vlerën e provës deklaratës së pasurisë në vitin 2009, duke e analizuar si të dhënë që vërteton pretendimin e subjektit në proces dhe duke e çmuar me rëndësi provuese.

25.10 Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e subjektit se lëvizja e likuiditeteve ishte bërë për arsye se në vitin 2008 kishte shpresuar të blinte banesën, ku edhe banonte me adresë: lagjja “S. L”, Lushnjë, nga shitësi i cili jetonte jashtë vendit dhe i ri-depozitoi në bankë, pasi nuk ra dakord me shitësin për blerjen e saj konfirmoheshin nga verifikimi i sistemit *TIMS* të shitësit N. M, hyrë në Shqipëri gjatë kësaj periudhe.

25.11 Trupi gjykues, pasi analizimit të deklaratës së pasurisë në vitin 2008 dhe 2009, dhe shpjegimeve të subjektit duke arsyetuar në tërësi me rrethanat e çështjes, arriti në përfundimin se subjekti ka pasaktësi në deklarimin e likuiditeteve të vitit 2008, mbi gjendjen *cash* këtë vit.

25.12 Trupi gjykues, vlerëson se pasaktësia e konstatuar për “burimin” reflektohet vetëm në mosdeklarimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2008, por ajo është korrigjuar nga subjekti në deklarimin për “burimin”, në vitin 2009, ku në momentin e depozitimit të këtyre vlerave monetare ka deklaruar saktësisht se janë vlerat e tërhequra në Raiffeisen Bank.

25.13 Trupi gjykues, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se pasaktësia e mosdeklarimit të gjendjes *cash* nuk ndikon në konkluzionin e arritur nga ky trup gjykues, mbi mundësinë financiare të tij në vitin 2009.

25.14 Interesat nga bono thesari në rezultate hetimi nuk u konsideruan të plota pasi shuma 2.700.000 lekë (1.500.000+1.200.000) nuk ishte konsideruar si e ardhur e ligjshme, për rrjedhojë, në zërin të ardhura nga interesat në bono thesari ishte vetëm pjesa takuese prej 50.271 lekësh, pasi u konsiderua si më lart shuma 2.700.000 lekë interesat nga bono thesari u përlllogariten në shumën 276.493 lekë. Analiza financiare finale, pas vlerësimit të provave, për subjektin e rivlerësimit rezultoi, si vijon:

<b>Analiza finale financiare</b>	<b>2009</b>
<b>PASURI</b>	<b>1,698,082</b>
Ndryshim likuiditeti	1,698,082
Total likuiditete deklaruar	6,628,681
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>1,698,082</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>2,038,562</b>
Të ardhura subjekti nga paga	1,160,926
Të ardhura bashkëshortja nga paga	427,805
Të ardhura deklaruar në deklaratën periodike	139,921
Të ardhura nga interesat e përfituara nga Raiffeisen Bank	33,417
Të ardhura nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit	276,493
<b>SHPENZIME</b>	<b>626,480</b>
Shpenzime jetike	546,480
Shpenzime për shkollimin e vajzave.	80,000
<b>Rezultati final financiar</b>	<b>-286,000</b>

25.15 Trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk subjekti ka pasur mundësi financiare të shtojë likuiditetin dhe të përballojë shpenzimet e tjera për vitin 2009 duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -286.000 lekë.

25.16 Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2009, pas analizës financiare të përditësuar në vlerën prej -286.000 lekësh, nuk është në masën që të përbëjë shkak për

shkarkimin e subjektit, për vetë faktin se analiza financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson.

## **26. ÇËSHTJE TË TJERA**

26.1 Nga hetimi është evidentuar se në deklaratën e parë para fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar autoveturë (pa specifikuar të dhëna), blerë me kontratë (pa referenca ) me vlerë 350.000 lekë, në proces regjistrimi, me burim nga të ardhurat familjare. Kjo autoveturë nuk është deklaruar më në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-të ndër vite si pakësim të pasurisë. Lidhur me këtë konstatim i është kërkuar subjektit të japë shpjegime.

26.2 Në përgjigje të pyetësorit të dytë, datë 18.12.2019, subjekti ka sqaruar se: *“Pasi e kam blere këtë autoveturë, ka punuar për pak kohë dhe pastaj u prish. Ajo në shumicën e kohës që e kam mbajtur ka qene e prishur. Ka qenë kjo arsyeja se përse unë nuk e kam regjistruar si mjet. U mundova ta rregulloj në dy tre raste, por pasi punonte për pak kohë ajo prishej përsëri. Meqenëse vlera e shitjes ishte e vogël dhe makina u shit pa dokument në një varreze makinash, atëherë veprimin e shitjes dhe vlerën e shitjes nuk e kam deklaruar.”*

26.3 Për sa më lart, subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e pasurisë në deklaratën periodike të vitit përkatës se kur e ka shitur këtë automjet.

26.4 Gjatë hetimit është evidentuar se sipas deklarimit të vitit 2008 subjekti ka deklaruar se i ka marrë hua shtetasit A. R (kunati i tij) shumën 5.000 euro në prill të vitit 2008 dhe ka deklaruar se ia ka kthyer në dhjetor të vitit 2008.

26.5 Nisur nga këto marrëdhënie të deklaruara me këtë shtetas, Komisioni bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga ky shtetas.

26.6 Në përgjigje subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës aktet: llogari e të siguruarit për periudhën 2002 – 2019, dhe vërtetim i sigurimeve shoqërore me nr. \*\*\*\*, datë 24.12.2019.

26.7 Komisioni konstatoi se aktet e paraqitura nga subjekti për të provuar mundësitë financiare të kunatit të tij, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar ligjore.

26.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka barrën e provës për të paraqitur dokumentacionin ligjor të paraqitur në formën e kërkuar ligjore (origjinal/njësi me origjinalin, të legalizuara/apostiluara), burimin e krijimit të pasurive të shtetasit A. R për shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

26.9 Pas kalimit të barrës së provës subjekti depozitoi dokumentacionin në formën e duhur ligjore, duke provuar mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi A. R.

26.10 Nga hetimi i Komisionit është evidentuar se vajza e subjektit H. D ka kryer pagesë tarifë shkolle *“master”* pranë B. A. të I.

26.11 Në përgjigje subjekti ka deklaruar se vajza e tij e madhe, H. D, studion në Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës, duke paraqitur dokumentacion ligjor provues për shpenzimet e shkollimit të saj.

26.12 Komisioni ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti dhe ka konsideruar në analizën financiare shpenzimet e shkollimit dhe qëndrimin në qytetin e Tiranës, për vajzën H. D. Për efekt të analizës financiare, shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas periudhës së qëndrimit (Tiranë / Lushnjë), të personit të lidhur, H. D.

### **Konkluzioni mbi vlerësimin e pasurisë**

26.13. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, nuk rezultojnë të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij.

26.14 Komisioni vlerëson se pasaktësitë ligjore në dokumentacionin mbi të cilin bazohet shkëmbimi i pasurive mes subjektit dhe vëllait dhe pasaktësia në deklaratimin *cash* në vitin 2008, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbejnë arsye të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

26.15 Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2009, pas analizës financiare të përditësuar në vlerën prej -286.000 lekësh, nuk është në masën që të përbejë shkak për shkarkimin e subjektit.

26.16 Sipas vlerësimit të trupit gjykues, kjo mungese e likuiditetit nuk përbenë cenim të besimit të publikut dhe nuk mund të përbejnë shkak për shkarkim, sipas pikës 61/3, pasi deklarimi në deklaratën *Vetting* është i saktë dhe ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara nga burime të ligjshme.

26.17 Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, trupi gjykues mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit z. Moisi Duda, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

27. DSIK pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*, datë 1.3.2019, ku rezultojnë se formulari i deklaratimit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

27.1 Rezultojnë se: subjekti i rivlerësimit i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të organizuar. Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Moisi Duda.*

### **Konkluzioni për kontrollin e figurës**

27.2 Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

27.3 Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE**

28. Vlerësimi profesional është kryer për subjektin e rivlerësimit nga institucioni ndihmës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky vlerësim është kryer mbi bazën e aftësive profesionale, organizative, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, aftësive personale

dhe angazhimit profesional, të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28.1 Raporti për analizën e aftësive profesionale, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është bazuar në formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat dhe dokumente të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

## **DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**

29. Gjatë periudhës së vlerësimit subjekti i rivlerësimit, prokurori Moisi Duda, ka përzgjedhur 3 (tri) dokumente ligjore, si vijon :

### **Konkluzione për vendimin penal nr. (\*\*\*\*) \*\*\*, datë 8.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës**

29.1 Dokumenti ligjor “konkluzione për vendimin penal nr. (\*\*\*) \*\*\*, datë 8.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës” është hartuar dhe nënshkruar nga vetë subjekti Moisi Duda, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Kërkesa është e datës 14.5.2015 dhe si e tillë është brenda periudhës së rivlerësimit.

29.2 Me këtë akt subjekti argumenton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i pabazuar për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Me vendimin nr. (\*\*\*\* ) \*\*\*, datë 8.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit A.Z për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” dhe në bazë të nenit 290/4 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 vjet e 6 muaj burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Z për veprën penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe në bazë të nenit 291 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 muaj burgim.*
- *Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit A. Z me 7 vjet burgim.*
- *Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e këtij dënimi, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri A. Z me 4 vjet e 8 muaj burgim.*
- *Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të mbetur, duke u vënë i pandehuri A. Z në provë për një periudhe kohe prej 3 vjetësh.*
- *Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit A. Z nga salla e gjykimit, nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.*
- *Në bazë të nenit 37 të Kodit Penal ndalohet i pandehuri A. Z për të drejtuar automjete për një kohe prej 3 vjet.*

29.3 Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori, i cili kërkon ndryshimin e vendimit, dënimin e të pandehurit A.Z, pa aplikuar pezullimin e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit.

29.4 Sipas subjektit, vendimi nr. (\*\*\*\*) \*\*\*, datë 8.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova, vetëm për sa i përket deklarimit fajtor të të pandehurit dhe cilësimit juridik të veprës penale, ndërsa, për sa i përket masës së dënimit dhe aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal vendimi nuk është i bazuar. Në caktimin e masës së dënimit gjykata nuk ka vlerësuar drejt rrethanat e çështjes.

29.5 Sipas subjektit, shkalla e lartë e përhapjes që ka vepra penale e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, pasoja tepër e rëndë që ka ardhur, vdekja e dy personave, drejtimi i automjeti në gjendje të dehur, drejtimi i automjetit me një shpejtësi shumë më të madhe se normat e



lejuara, mosrregullimi i marrëdhënieve me familjarët e viktimave, janë disa nga arsyet që gjykata nuk duhet të kishte caktuar ndaj të pandehurit A. Z atë masë dënimi dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

29.6 Gjykata ka zbatuar nenin 59 të Kodit Penal, duke argumentuar se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të pakët, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë, ka bërë të gjitha përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me familjarët e viktimave, shfaq pendim të thellë, viktimat ishin miq të tij dhe humbja ka qenë e rëndë dhe e drejtpërdrejtë për të, është i pamartuar, pa krijuar familje dhe gjatë qëndrimit në paraburgim ka shfaqur probleme shëndetësore.

29.7 Argumentimi që bën gjykata është i pabazuar në prova dhe në ligj. Në nenin 59 të Kodit Penal janë përcaktuar kriteret që duhet të plotësohen me qëllim që të pezullohet ekzekutimi i vendimit me burgim për të pandehurin.

29.8 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 31, datë 5.2.2014, ka theksuar: “ ... kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim mund të aplikohet nga gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative 3 kushte, dënimi me burg deri në 5 vjet, rrezikshmëria e pakët e personit dhe rrethana të veçanta të kryerjes së veprës penale. Mungesa qoftë dhe njërit prej tyre bën që dispozita të mos gjejë zbatim. Në interpretim të përmbajtjes së dispozitës së mësipërme, kur gjykata vlerëson se për një të dënuar me burgim duhet të aplikohet kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit, është detyrim i saj që të arsyetojë dhe të argumentojë ekzistencën e tri kushteve të mësipërme...”

29.9 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 77, datë 25.5.2011, ka theksuar: “ ... kur gjykatat e faktit zbatojnë dispozitën e nenit 59 të Kodit Penal nuk duhet të kufizohen vetëm në konstatimin formal të rrezikshmërisë së pakët shoqërore të personit që është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim deri në 5 vjet (ekzistencën e personalitetit të mirë, moshën etj., rrethana që mund t'i shqyrtojnë rast pas rasti) apo të rrethanave të kryerjes së veprës penale, por duhet të argumentojnë ato prova dhe fakte të cilat i çojnë në zbatimin e saj”.

29.10 Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndonëse është shprehur që shkalla e rrezikshmërisë së të pandehurit është e pakët, nuk ka argumentuar se në cilat rrethana është bazuar për arritjen në një konkluzion të tillë. Nga provat e administruara në dosje nuk provohet që rrezikshmëria e të pandehurit A.Z të jetë e pakët. Pavarësisht qëndrimit të penduar që ka mbajtur i pandehuri, duhet theksuar se rrethanat më të rëndësishme që përcaktojnë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore janë ato që kanë të bëjnë me rrethanat dhe veprimet konkrete që ka kryer i pandehuri. Veprimet që ka kryer i pandehuri dhe që duheshin vlerësuar nga gjykata janë ato që kanë të bëjnë me shkeljet e neneve përkatëse të Kodit Rrugor, shkelje që kanë sjellë edhe pasojën. Rezulton e provuar nga aktekspertimi autoteknik që i pandehuri A.Z ka shkelur rregullat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 139, pikën 1, të nenit 140 dhe pikën 1 të nenit 184 të Kodit Rrugor.

29.11 Nga aktekspertimi autoteknik rezulton që i pandehuri ka ecur me një shpejtësi prej 154 km/orë, në një kohë që shpejtësia e lejuar është 90 km/orë, pra 64 km/orë mbi shpejtësinë e lejuar. Nga aktekspertimi toksikologjik - ligjor nr. \*\*\*, datë 12.12.2013, ka rezultuar se sasia e alkoolit në gjakun e të pandehurit A. Z ishte në masën 1.39 g/litër, sasi kjo mbi trefishin e lejuar me Vendimin Nr. 153, datë 7.4.2006, të Këshillit të Ministrave. I pandehuri e ka drejtuar automjetin tip “\*\*\*” me targa CZ \*\*\* BJ në gjendje të dehur dhe si rezultat i drejtimit të automjetit në gjendje të dehur dhe shpejtësisë tepër të madhe, ai ka humbur kontrollin e automjetit dhe si pasojë është përplasur dhe kanë gjetur vdekjen shtetasit F.M dhe M. B, të cilët ndodheshin në automjet.

29.12 I pandehuri ka konsumuar elementet e një veprë penale me rrezikshmëri të madhe shoqërore, rrezikshmëri kjo që përcaktohet nga shkalla e lartë e përhapjes që ka vepra penale

e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, si dhe nga sanksioni tepër i lartë që parashikohet nga kjo dispozitë, ku minimumi i dënimit me burgim është 5 vjet. Marrëdhëniet midis të pandehurit dhe familjarëve të viktimave nuk janë normalizuar. Ndonëse gjykata është shprehur në vendim që i pandehuri ka bërë përpjekje për rregullimin e marrëdhënieve me familjarët e viktimave, nga provat e administruara në dosje nuk rezulton që këto marrëdhënie të jenë rregulluar.

29.13 Për sa më sipër, subjekti arrin në konkluzionin që sjellja e të gjykuarit si gjatë kryerjes së veprës penale edhe pas kryerjes së saj nuk mund të përkufizohet si “rrezikshmëri e pakët shoqërore”, në kuptim të nenit 59 të Kodit Penal.

29.14 Në këtë çështje nuk provohet asnjë “rrethanë e veçantë” nga ato që kërkon neni 59 i Kodit Penal. I pandehuri A. Z është deklaruar fajtor dhe është dënuar për një veprë penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, e cila parashikon dënim me burgim në minimum 5 vjet dhe me një përhapje të gjerë jo vetëm në rrethin e Durrësit por edhe më gjerë. Rrethanat e kryerjes së kësaj veprë penale dhe pasoja e ardhur prej saj janë shumë të rënda. Në këto kushte, nuk provohet asnjë “rrethanë e veçantë”, që të justifikojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burg, prandaj dhe aplikimi i tij nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk i shërben përmbushjes së qëllimit të dënimit të dhënë ndaj të pandehurit.

29.15 Në fund, subjekti i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Durrës që të dënojë përfundimisht të pandehurin me 6 vjet burgim, pa aplikuar nenin 59 të Kodit Penal.

29.16 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.9.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*\*, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

29.17 Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*\* i vendimit (\*\*), datë 29.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 9.9.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës, me këtë ndryshim: *mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për të gjykuarin A. Z.*

29.18 Prokurori në mënyrë të qartë reflekton një përgatitje të mirë juridike, pasi ka argumentuar qartësisht pabazueshmërinë e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurin A. Z. Analiza e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është bërë e mbështetur në Kodin Penal dhe në vendime të Gjykatës së Lartë. Akti rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike.

### **Konkluzione për vendimin penal nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

29.19 Dokumenti ligjor “konkluzione për vendimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan” është hartuar dhe nënshkruar nga vetë subjekti Moisi Duda, i cili e ka nënshkruar në cilësinë e hartuesit të këtij akti ligjor. Kërkesa është e datës 12.4.2016 dhe si e tillë është brenda periudhës së rivlerësimit.

29.20 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit A. Ll, për veprën penale “mashtrim”, e parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, si dhe të nenit 47 të Kodit Penal dënimin e tij me 1 vit burgim.*

29.21 Kundër vendimit ka bërë ankim i pandehuri, i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe deklarimin e pafajshëm. Subjekti argumenton përse pretendimet e të dënuarit nuk qëndrojnë.

29.22 Vendimi nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova, për sa i përket deklarimit fajtor të të pandehurit, cilësimit juridik të veprës penale dhe masës së dënimit.

29.23 I pandehuri pretendon se gjatë hetimeve paraprake janë bërë shkelje procedurale që kanë çuar në pavlefshmëri absolute të akteve dhe, për këtë arsye, vendimi i gjykatës duhet të prishet. Sipas të pandehurit, gjatë hetimeve paraprake nuk ka pasur mbrojtës, pasi nuk i është caktuar nga prokuroria dhe se caktimi i avokates mbrojtëse kryesisht nga prokurori është bërë në mënyre arbitrare dhe se ajo nuk ka mbrojtur interesat e tij në hetim, por, përkundrazi, ka cenuar interesat e tij. Ky pretendim i të pandehurit nuk është i bazuar. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se i pandehuri A. Ll është pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 29.6.2012. I pandehuri ka deklaruar se do të japë shpjegime pa praninë e avokatit. Ai pretendon se për këtë rast nuk është njoftuar me fletëthirrje sipas ligjit, por verbalisht nga oficeri i policisë gjyqësore në kohën që po kalonte para prokurorisë dhe se kjo ishte shkelje procedurale, e cila çonte në pavlefshmërinë e njoftimit.

29.24 Njoftimi verbal i të pandehurit nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është shkelje procedurale. Ligjvënësi ka parashikuar disa mënyra për njoftimin e akteve të prokurorit, por kjo nuk do të thotë se njoftimi i këtyre akteve nuk mund të bëhet edhe me mënyra të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara nga ligjvënësi. Në rastin konkret, njoftimi i të pandehurit është bërë verbalisht nga oficeri i policisë gjyqësore dhe i pandehuri është paraqitur dhe është pyetur, ku nuk ka ndonjë shkelje në lidhje me njoftimin e bërë. Në datat 13.12.2012 dhe 24.12.2012, prokurori ka bërë ftesa për paraqitjen e të pandehurit në prokurori, si dhe urdhra për shoqërimin e detyrueshëm të tij në prokurori, përkatësisht në datat 20.12.2012 dhe 28.12.2012. Nga raportet e shërbimit të mbajtura nga punonjësit e policisë, përkatësisht në datat 28.12.2012 dhe 4.1.2013, ka rezultuar se banesa e të pandehurit ishte e mbyllur dhe ishte larguar familjarisht pa asnjë adresë. Për këtë arsye, prokurori ka vendosur në datën 18.1.2013 mosqetjen e të pandehurit A. Ll dhe në datën 21.1.2013 ka caktuar avokate kryesisht znj. S.T. Njoftimi i akteve nga ky moment i është bërë avokates së caktuar kryesisht, sipas nenit 141/1 të Kodit të Procedurës Penale. Në datën 22.1.2013 është bërë njohja e avokates mbrojtëse me aktet e hetimit dhe procesverbali është firmosur prej saj, duke u dërguar më pas çështja për gjykim. Në këto kushte nuk vërehej asnjë shkelje procedurale gjatë hetimeve paraprake. Në gjykimin në apel i pandehuri, nëpërmjet avokatit mbrojtës, pretendoi për shkelje procedurale.

29.25 Gjyqtari T. T ka marrë çështjen për gjykim nga një tjetër gjyqtar i mëparshëm, në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe ka pranuar të vazhdojë gjykimin atje ku e kishte lënë gjyqtari i parë edhe pse ishte ndërruar i gjithë trupi gjykues i përbërë në fakt nga gjyqtari i vetëm. Sipas tij kjo shkelje procedurale përbën shkak për pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës, e cila çon në prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim. Pretendimi i të pandehurit nuk ka bazë ligjore. Gjykimi është filluar nga gjyqtarja P. F. Pas disa seancash gjyqësore gjyqtarja ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, duke parashtruar dhe arsyet ligjore. Kjo kërkesë është pranuar nga kryetari i gjykatës. Në këto seanca gjyqësore gjykimi i çështjes ka shkuar deri në momentin kur prokurori ka lexuar kërkesën për gjykim dhe ka kërkuar që të merren provat, duke përcaktuar edhe radhën e marrjes së provave. Ndërsa i pandehuri nuk ka kërkuar që të merren prova, por i ka kërkuar gjykatës që të rezervonte të drejtën për marrjen e provave në fazat e mëvonshme të gjykimit. Nga ana e gjyqtares nuk është marrë asnjë provë. Pas heqjes dorë të gjyqtares dhe pranimi të kërkesës së saj nga kryetari i gjykatës, me short, çështja i ka rënë për gjykim gjyqtarit T. T.

29.26 Në seancën e datës 5.7.2013 gjyqtari T.T, pasi është njohur me aktet e çështjes penale, ka vendosur të vazhdojë gjykimin në fazën në të cilën ndodhet çështja, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Fakti i vazhdimi të gjyqimit të çështjes në fazën në të cilën ndodhej, nga ana e gjyqtarit T. T nuk përbën shkelje procedurale të tillë që të çojë në prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim, për arsye se:

29.27 Së pari, në të gjitha seancat e zhvilluara nga gjyqtarja P. F nuk është marrë asnjë provë. Së dyti, edhe nga gjyqtari T. T nuk është marrë asnjë provë në të gjitha seancat e zhvilluara prej tij. Së treti, gjyqtari S.K, i cili është përzgjedhur me short për gjykimin e kësaj çështjeje, pas heqjes dorë të gjyqtarit T. T ka filluar shqyrtimin e çështjes nga e para.

29.28 Gjatë gjykimit të çështjes nga gjyqtari S. K janë marrë të gjitha provat në analizë të të cilave është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit A.Ll. Pretendimi i të pandehurit për pavlefshmëri të vendimit të gjykatës nuk qëndron, pasi veprimet e kryera nga gjyqtari T. T nuk kanë asnjë lidhje me veprimet që ka kryer gjyqtari S.K. Gjyqtari S.K e ka shqyrtuar çështjen nga fillimi, duke respektuar të gjitha rregullat procedurale i cili ka marrë dhe vendimin.

29.30 Gjatë gjykimit të çështjes, meqenëse i pandehuri ka kërkuar të mbrohet me avokat mbrojtës, por nuk ka pasur mundësi financiare për ta siguruar vetë mbrojtësin i është caktuar nga gjykata avokat kryesisht. Ka qenë avokati F.D, i caktuar kryesisht nga gjykata, që ka realizuar mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit në gjykim. Në këto kushte rezulton që ndaj të pandehurit është respektuar edhe kjo garanci procedurale.

29.31 Më pas, subjekti ka paraqitur rrethanat e faktit:

29.32 I pandehuri ka punuar në biznesin e shtetasit S. A me të cilin ka edhe lidhje familjare. I pandehuri shiste pllaka për shoqërinë “Q. E. 2006” sh.p.k., në pronësi me shtetasin S. A. Pasi fillimit të punës në këtë biznes, i pandehuri shiste pllaka dhe nuk arkëtonte për llogari të shoqërisë paratë që merrte nga shitja. Subjekti përmend në akt deklarimet e shtetasve S. A, i cili është edhe i dëmtuar, dëshminë e shtetasve S. Xh dhe E. I, dëshmitarit N. C, të cilit iu lexuan thëniet në seancë, pasi ndodhej në Itali.

29.33 Nga provat rezulton se i pandehuri ka përfituar 1.000.000 lekë nga shitja e pllakave të shoqërisë ku punonte, duke mos i arkëtuar këto para për shoqërinë.

29.34 Sipas subjektit, me provat e cituara provohet fajësia e të pandehurit A. Ll, si autor i veprës penale “mashttrim”, e parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, prandaj edhe gjykata me të drejtë e ka deklaruar fajtor për këtë veprë penale. Në fund, subjekti i kërkon Gjykatës së Apelit Durrës lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

29.35 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*\*\*(\*\*\*), datë 12.4.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

29.36 Ky akt rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Akti është ndërtuar sipas standardit të një kërkesë të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese dhe argumentuese dhe në fund kërkimet dhe parashtrimi i bazës ligjore. Në akt subjekti bën analizë të pretendimeve të të pandehurit, duke argumentuar ligjërisht pabazueshmërinë e pretendimeve të të pandehurit.

**Konkluzione për vendimin penal nr. \*\*\*\*\*(\*\*\*), datë 13.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

29.37 Dokumenti ligjor “konkluzione për vendimin penal nr. \*\*\* (\*\*\*)”, datë 13.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë” është hartuar dhe nënshkruar nga vetë subjekti Moisi Duda, i cili e ka nënshkruar në cilësinë e hartuesit të këtij akti ligjor. Vendimmarrja është e datës 10.9.2014 dhe si e tillë është brenda periudhës së rivlerësimit.

29.38 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*)”, datë 13.5.2014, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit E. G për kryerjen e veprës penale “vjedhje me armë” në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre neneve, dënimin e tij me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E. G për kryerjen e veprës penale “vjedhje me dhunë”, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e tij me 5 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E. G për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, e parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 2 vjet burgim.
- Në bazë të nenit 55/1 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit E. G në një dënim të vetëm, më të rëndë, të shtuar prej 15 vjet burgim.

29.39 Kundër vendimit ka bërë ankim i pandehuri nëpërmjet avokatit mbrojtës, i cili kërkon ndryshimin e vendimit, deklarin e pafajshëm.

29.40 Sipas subjektit, vendimi nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 13.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, si për sa i përket deklarin fajtor të të pandehurit, cilësimit juridik të veprave penale, ashtu edhe masës së dënimit. Gjykata ka zbatuar drejt normat procedurale që kanë të bëjnë me kompetencën territoriale dhe konkretisht normat e përcaktuara në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Penale. Neni përcakton se: “Kompetenca tokësore për procedimet e lidhura, për të cilat disa gjykata kanë të njëjtën kompetencë lëndore, i përket gjykatës kompetente për veprën penale më të rëndë dhe në rast se veprat janë njëlloj të rënda gjykatës kompetente për veprën që është regjistruar e para”.

29.41 Në rastin konkret: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit E. G, akuzuar për veprat penale “vjedhje me armë, kryer në bashkëpunim,” “vjedhje me dhunë” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 140-25, 139 dhe 278/2 të Kodit Penal. I pandehuri E.G është akuzuar nga Prokuroria Kavajë për veprat penale të parashikuar nga nenet 140 dhe 25 dhe 278/2 të Kodit Penal për ngjarjen e ndodhur në fshatin L, Kavajë dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal për ngjarjen e ndodhur në hyrje të rrugës Elbasan-Metalurgjik. Nisur nga sanksionet që parashikojnë nenet e mësipërme, rezulton se vepra penale më e rëndë është ajo e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal, që i përket ngjarjes së ndodhur në fshatin L, Kavajë dhe kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje, bazuar në përcaktimin e bërë në paragrafin e parë të nenit 82 të Kodit të Procedurës Penale, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Prokuroria Kavajë ka zbatuar normat procedurale që kanë të bëjnë me kompetencën tokësore për shkak të lidhjes së procedimeve. Rezulton se në datën 18.1.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. \*\* në ngarkim të të pandehurit E. G, për veprat penale “vjedhje me armë” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 140 dhe 278/2 të Kodit Penal, për vjedhje të kryer në datën 13.1.2012, në pikën e karburantit “T. O”, që ndodhet në hyrje të rrugës Elbasan-Metalurgjik.

29.42 Pas kryerjes së hetimeve, prokuroria ka arritur në konkluzionin që kjo vjedhje është kryer nga i pandehuri E. G, i cili nuk e ka kryer me armë, por e ka kryer me dhunë. Në këto kushte, sipas bindjes së prokurores së çështjes i pandehuri duhej të akuzohej për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Prokuroria e çështjes është vënë në dijeni të faktit se në ngarkim të të pandehurit E. G ishte regjistruar një procedim tjetër penal nga Prokuroria Kavajë, për veprat penale “vjedhje me armë” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 140-25 dhe 278/2 të Kodit Penal, dhe bazuar në kërkesat e neneve 28 dhe 82/1 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur në datën 18.9.2012 të shpallë moskompetencën për këtë procedim penal dhe t’i kalojë aktet e procedimit për kompetencë Prokurorisë Kavajë. Prokuroria Kavajë, me vendimin e datës 24.9.2012, ka vendosur

bashkimin e këtij procedimi penal me atë të filluar nga kjo prokurori dhe që mbante numrin 23. Në datën 23.12.2012 prokurori e ka marrë të pandehur shtetasin E. G për veprat penale të parashikuara nga nenet 140-25, 139 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe me këto akuza e ka dërguar çështjen për gjykim.

29.43 Sipas subjektit këto arsye ligjore e bëjnë të bazuar qëndrimin e prokurorit gjatë hetimeve paraprake dhe të gjykatës gjatë gjykimit në lidhje me kompetencën tokësore. Edhe në lidhje me deklarinimin fajtor të të pandehurit E.G, gjykata ka analizuar me objektivitet dhe në unitet të gjitha provat e administruara në dosje. Më pas, subjekti paraqet rrethanat e çështjes, episodi i vjedhjes, i ndodhur në pikën e karburantit në fshatin L, Kavajë.

29.44 Në datën 19.1.2012, rreth orës 1:20, në pikën e karburantit “T. O”, që ndodhet në fshatin L, Kavajë, kanë shkuar dy persona, njëri prej të cilëve me automatik. Këta shtetas janë futur në zyrën e punonjësit të karburantit dhe nën kërcënimin e armës i kanë marrë shtetasit J. K 30.000 lekë, si dhe telefonin celular. Pasi kanë marrë sendet e mësipërme, ata e kanë mbyllur të dëmtuarin J.K me çelës në zyrën e tij dhe pas kësaj kanë qëlluar në ajër me automatik. Pas kësaj ata janë larguar me një automjet në drejtim të Kavajës. I dëmtuari J.K ka dalë nga dritarja e zyrës, ka shkuar në shtëpi dhe me telefonin e babait ka njoftuar policinë. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se janë gjetur dy gëzhoja të cilat janë sekuestruar. Ka rezultuar se aparati i celularit që kishte i dëmtuari, i tipit N, i është sekuestruar dëshmitari H. C. Djali i tij, së bashku me bashkëshorten, kanë deklaruar se këtë aparat telefoni ia kanë blerë të pandehurit E. G për shumën 500 lekë. Dëshminë e tyre e mbështet edhe dëshmitari J. M, i cili ka qenë prezent kur i pandehuri i ka shitur telefonin dëshmitarit për 500 lekë. Në aparatin e telefonit të rojës së karburantit ishte përdorur edhe një numër tjetër telefoni që i përkiste shtetasës M. C. Sipas subjektit këto fakte provojnë që vjedhjen e pikës së karburantit në fshatin L, Kavajë, në datën 19.01.2012 e ka kryer i pandehuri E. G, në bashkëpunim me një person tjetër, të pidentifikuar. Episodi i vjedhjes të ndodhur në datën 13.1.2012, në pikën e karburantit “T. O” që ndodhet në hyrje të rrugës Elbasan-Metalurgji:

29.45 Në datën 14.1.2012, në orën 1:00, në dhomën në të cilën po qëndronte i dëmtuari B.P, punonjës në pikën e karburantit “T.O”, ka hyrë një person i armatosur me automatik. Ky person i ka kërkuar t’i jepte paratë dhe celularin. Personi me automatik ka marrë 40.000 lekë dhe telefonin celular të të dëmtuarit B.P dhe është larguar menjëherë. Aparati i telefonit i të dëmtuarit B.P ishte i tipit N, me shinë dhe kamera. Pas vjedhjes ky aparat u gjend në përdorim nga dëshmitari K.S. Ky dëshmitar si edhe dëshmitarët S.S dhe E.T kanë deklaruar se këtë aparat celulari ia ka shitur dëshmitari E. T, por se ky aparat nuk ishte i tij por i të pandehurit E.G, i cili i kishte thënë që ta shiste.

29.46 Nga analiza e tabulateve dhe numrave *IMEI* të telefonave të sekuestruar ka rezultuar se i pandehuri E. G ka realizuar vjedhjen e datës 14.1.2012 në pikën e karburantit “T.O” në rrugën Elbasan-Metalurgjik. I pandehuri pretendon se të dy aparatet e telefonit i ka blerë në Elbasan, pranë stadiumit, tek një person në të njëjtën ditë, duke i shitur më pas. Alibia e të pandehurit sipas subjektit nuk qëndron, pasi telefonat celularë nuk janë vjedhur në të njëjtën ditë, por janë vjedhur në ditë të ndryshme, i pari në datën 14.1.2012 dhe tjetri në datën 19.1.2012.

29.47 Në përfundim, subjekti arrin në konkluzionin që gjykata ka analizuar në unitet dhe me objektivitet të gjitha provat e administruara, prandaj dhe vendimi i saj është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

29.48 Akti rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike.

### **30. PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE, TË PËRZGJEDHURA ME SHORT**

**Dosja nr. \*\* Konkluzione për vendimin penal nr. \*\*(\*\*\*\*), datë 24.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

30.1 Akti është i datës 18.2.2015, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës. Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti Moisi Duda, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

30.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*(\*\*\*)\*, datë 24.7.2014, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit B. D, për veprën penale “vjedhje me dhunë, në bashkëpunim” dhe në bazë të neneve 139 dhe 25 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 vjet burgim.*

30.3 Kundër vendimit ka bërë ankim i pandehuri, i cili kërkon prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes. Subjekti argumenton me këtë akt se vendimi nr. \*\*\*(\*\*\*)\*, datë 24.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj. Gjykata me të drejtë e ka deklaruar fajtor të pandehurin B.D për veprën penale “vjedhje me dhunë, në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal.

30.4 Subjekti bën një paraqitje të rrethanave të faktit: dëshmitari A.S punon si shitës në karburantin “B-O”, që ndodhet në anë të rrugës nacionale Peqin-Rrogozhinë. Në datën 28.2.2013, rreth orës 21:50, ka ardhur te karburanti një mjet me ngjyrë të zezë, brenda të cilës ndodheshin 3 persona. Kur dëshmitari është afruar, nga mjeti ka dalë drejtuesi i saj i cili i ka kërkuar ta furnizonte me 10.000 lekë benzinë dhe njëkohësisht e ka pyetur se sa larg ishte qyteti i Fierit. Nga automjeti ka dalë edhe një person tjetër i cili ishte i ulur në vendin e parë të pasagjerit. Ky shtetas mbante në dorë një pistoletë dhe pasi ia ka vënë në kokë dëshmitarit i ka kërkuar që të mos kthehej. Drejtuesi ka mbushur me benzine automjetin dhe 4 bidonë plastikë që janë nxjerr nga automjeti. Personi që i kishte drejtuar pistoletën e ka detyruar dëshmitarin të futej në zyrën e pikës së karburantit, duke e detyruar që të mos kthente kokën. Më pas, ky shtetas është larguar me vrap menjëherë dhe ka hipur tek automjeti që e priste në hyrje të pikës së karburantit. Dëshmitari ka parë automjetin që largohej me shpejtësi dhe ka bërë të mundur të fiksojë një pjesë të targës, geramat AA dhe numrat \*\*. Pranë pompës ka parë një nga bidonët e harruar nga autorët. Dëshmitari A.S ka shpjeguar se drejtuesi i automjetit ishte me gjatësi rreth 160-165 cm, me fytyrë të dobët dhe të gjatë, flokë të shkurtër, i moshës 25-30 vjeç, me veshë të dalë përpara, me hundë të gjatë e të hollë dhe fliste me dialekt verior.

30.5 Nga aktekspertimi daktiloskopik rezulton se gjurmët papilare të gjetura në bidonin plastik të sekuestruar në vendin e ngjarjes i përkasin të pandehurit B.D. Gjykata me të drejtë ka arritur në konkluzionin që tiparet e përshkruara nga dëshmitari përkojnë me ato të të pandehurit B. D.

30.6 Në lidhje me provueshmërinë e fajësisë, i pandehuri pretendon se vendimi i gjykatës nuk është i bazuar, pasi nuk ka prova për ta deklaruar fajtor dhe se prova e vetme ku është bazuar gjykata për ta deklaruar fajtor të pandehurin është e dyshimte, pasi gjurmët e gishtave të gjetura në bidonin plastik të sekuestruar në vendin e ngjarjes dhe që i përkasin atij janë lënë para se shoferi i mjetit ta nxirrte bidonin nga mjeti dhe se këto gjurmë mund të jene lënë në dhjetëra mundësi te ndryshme. Për ta bazuar pretendimin e vet, i pandehuri i referohet vendimit nr. 876, datë 21.12.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Pretendimi i të pandehurit nuk është i bazuar pasi duhet theksuar se konkluzioni i kësaj gjykate ka të bëjë me çështje konkret, nisur dhe nga fakti që gjurmët e të pandehurit në çështjen objekt shqyrtimi nga Gjykata e Lartë nuk ishin marrë në formën e kërkuar nga ligji. Në rastin konkret, gjurmët janë marrë në formën e kërkuar dhe se aktekspertimi daktiloskopik është i lidhur edhe me provat të tjera.

30.7 Subjekti i kërkon Gjykatës së Apelit, lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*(\*\*\*)\*, datë 24.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga konsultimi me faqen zyrtare të



Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, rezulton se me vendimin nr. \*\*\*\*, datë 18.2.2015, kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

30.8 Akti rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Në akt subjekti argumenton në lidhje me pabazueshmërinë e pretendimeve të të pandehurit duke iu referuar ndër të tjera edhe vendimeve të Gjykatës së Lartë.

**Dosja nr. \* Konkluzione për vendimin penal nr. \*\*\*\*(\*\*), datë 3.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

30.9 Akti është i datës 16.3.2016, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës. Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti Moisi Duda në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

30.10 Në këtë akt subjekti ka analizuar se përse nuk qëndron argumentimi që ka bërë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për të pushuar gjykimin ndaj dy të pandehurve të akuzuar për veprat penale të “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” dhe “falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, vepra këto të parashikuara nga nenet 189/1 dhe 191/1 të Kodit Penal.

30.11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. \*\*\*(\*\*), datë 23.2.2015, ka vendosur pushimin e gjyimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve G.S, i akuzuar për veprat penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” dhe “falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, vepra këto të parashikuara nga nenet 189/1 dhe 191/1 të Kodit Penal dhe B.Sh, e akuzuar për veprën penale të “falsifikimit të akteve të gjendjes civile” të parashikuar nga neni 191/3 i Kodit Penal, pasi çështja nuk duhet të fillonte për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

30.12 Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori i çështjes i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe deklarimin fajtor të të dy të pandehurve për veprat penale për të cilët janë akuzuar.

30.13 Subjekti i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Durrës, ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*), datë 23.2.2015, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke deklaruar fajtorë të dy të pandehurit për veprat penale që janë akuzuar, si edhe fshirjen nga regjistri i gjendjes civile të Komunës Gosë të emrit të pandehurit G. S.

30.14 Me vendimi nr. \*\*\*\*, datë 1.6.2016, Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur:

- *Lënie në fuqi të vendimit penal nr. \*\*\*\*(\*\*), datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për sa i përket pushimit të çështjes ndaj të pandehurit G.S për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 191/1 i Kodit Penal. Ndryshimin e këtij vendimi në pjesën tjetër, si më poshtë:*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit G. S për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij më 6(gjashtë) muaj burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurës B. Sh për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 191/3 të Kodit Penal dhe dënimin e saj më 1(një) vit burgim.*
- *Në mbështetje të nenit 59 të Kodit Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurës B.Sh, duke e vënë në provë për një kohë prej 2 vjetësh.....*

30.15 Fillimisht në vendim analizohet në mënyrë të detajuar veprimtaria hetimore e kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më tej, parashtrohen dhe analizohen argumentet që ka përdorur Gjykata Rrethit Gjyqësor Kavajë në raport me besueshmërinë e vendimit të pushimit. Shkaqet e pabazueshmërisë janë ndërtuar duke analizuar edhe kohën e kryerjes së veprave penale nga të dy të pandehurit, kohë e cila nuk është marrë në konsideratë.

**Dosja nr. \* Rekurs kundër vendimeve penale nr. \*\*\* (10-2015-2866), datë 28.12.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr. \*\*\* (13-2011-3494), datë 14.7.2011, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan**

30.16 Akti është i datës 18.1.2016 dhe i është drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

30.17 Në fillim të aktit subjekti prezanton vendimin penal nr. \*\*\*(\*\*\*\*), datë 14.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit I.J, për veprën penale “prodhim dhe shitja e narkotikeve”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Deklarimin fajtor të të pandehurit E. A për veprën penale “moskallëzim të krimit” parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.*

30.18 Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori, i cili kërkon ndryshimin e vendimit, deklarimin fajtor të të pandehurit E.A për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*\*), datë 28.12.2015, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\* (\*\*\*\*), datë 14.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

30.19 Me këtë akt subjekti argumenton pabazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe atë të Gjykatës së Apelit Durrës për sa i përket deklarimit fajtor të të pandehurit E.A për veprën penale “moskallëzim i krimit”, pasi sipas subjektit duhet të deklarohet fajtor për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe duhej të dënohej për këtë veprë penale.

30.20 Sipas subjektit, vendimi nr. \*\*\* (\*\*\*\*), datë 14.7.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk është i bazuar për sa i përket ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale për të pandehurin E. A dhe masës së dënimit për këtë të pandehur, ndërsa në pjesët e tjera vendimi është i drejtë. Gjykata ka vendosur të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale për të pandehurin E.A, nga “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” e kryer në bashkëpunim me të pandehurin I. J dhe shtetasin R.N, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, në veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal. Sipas gjykatës, vepra penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” është kryer nga të dy të pandehurit e tjerë dhe se i pandehuri E. Ai, nuk ka kryer asnjë veprim, nuk ka komunikuar dhe biseduar me askënd për faktin që po ndodhte, nuk ka luajtur asnjë rol, qoftë edhe minimal implikimi.

30.21 Ky arsyetim nuk është i bazuar në provat e administruara dhe konkretisht nga deklarimet e shtetasve R.N dhe M.I, deklarimet e të pandehurve I. J dhe E.A, aktekspertimet toksikologjike për të tre personat e përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

30.22 Më pas subjekti paraqet rrethanat e faktit. Këto elemente, sipas subjektit tregojnë faktin që i pandehuri E.A jo vetëm që ka ditur për këtë veprimtari, por që ka kryer edhe veprime konkrete duke vënë në dispozicion dhe vlerat monetare që duheshin për rrugëtim dhe për blerjen e lëndës narkotike. Në këto rrethana është e pa bazuar që të shkëputeshin veprimet e të pandehurit E.A nga ajo e dy personave të tjerë, në lidhje me lëndën narkotike. Nuk është logjike që të ndahet përgjegjësia penale e të dy të pandehurve, vetëm për faktin se qeset i kishte në dorë i pandehuri I. J, kur është vërtetuar se përgjatë gjithë ditës ata nuk janë ndarë nga njeri-tjetri dhe se çdo veprim e kanë kryer së bashku.

30.23 Gjykata ka gabuar në këtë rast kur ka vlerësuar nga ana objektive faktin se meqenëse qesja me lëndën narkotike është mbajtur nga i pandehuri I. J, nuk ka përgjegjësi për këtë fakt i pandehuri E.A. Sipas kësaj logjike ky i pandehur nuk duhej të mbante përgjegjësi as për veprën penale të moskallëzimit të krimit, pasi gjithnjë sipas kësaj logjike nuk rezulton që të kishte dijeni se çfarë kishte në qese. Këtë fakt nuk e konfirmon askush, çka tregon se gjykata e nënkupton faktin sikur i pandehuri ka dijeni për çfarë kishte në qese. Nga aktekspertimi toksikologjik nr. \*\*\*, datë 3.7.2010, ka rezultuar se në monstrën e urinës së të pandehurit E.A

është zbuluar prania e produkteve të metabolizmit të kanabinoideve, provë kjo që e lidh të pandehurin E. A me prezencën e lëndës narkotike që u bllokua nga policia.

30.24 Duke kundërshtuar sa argumenton gjykata në vendimin e saj, del më në pah fakti se i pandehuri E.A është bashkëpunëtor me të pandehurin I.J për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe, për këtë arsye, duhej deklaruar fajtor për këtë vepër penale. Në këto rrethana nuk rezulton e provuar ajo që arsyeton gjykata në vendim, se i pandehuri E. A nuk ka kryer veprime në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Në fund të aktit subjekti i ka kërkuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*\*), datë 28.12.2015 dhe deklarimin fajtor të të pandehurit E. A për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

30.25 Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

30.26 Akti rezulton i strukturuar në mënyrë logjike, i ndarë në kategori tematikash. Fillimisht, në akt, analizohen vendimet e të dy gjykatave të shkallës së parë dhe të Apelit. Më pas, subjekti paraqet faktet që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor, duke individualizuar veprimet e të pandehurit me veprën penale për të cilën duhet të shpallet fajtor.

**Dosja nr. \* Konkluzione për vendimin penal nr.\*\*\* (\*\*\*\*), datë 19.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.**

30.27 Dokumenti ligjor “konkluzione për vendimin penal nr.\*\*\*(\*\*\*\*), datë 19.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan” është hartuar dhe nënshkruar nga subjekti Moisi Dudaj, i cili e ka nënshkruar në cilësinë e hartuesit të këtij akti ligjor. Akti është i datës 20.10.2014 dhe është në 3 faqe, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës dhe, si e tillë, është brenda periudhës së rivlerësimit.

30.28 Subjekti, me këtë akt, argumenton se masa e sigurimit e vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan “detyrim për paraqitje” nuk është e drejtë.

30.29 Në fillim të aktit, subjekti sqaron se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.\*\*\* (\*\*\*\*), datë 19.9.2014, ka vendosur të caktojë si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim, z. S. Sh atë të “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Prokurori, kundër vendimit, ka bërë ankim dhe kërkon ndryshimin e vendimit dhe caktimin si masë sigurimi “arrest në burg”.

30.30 Subjekti bën një analizë të vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe sipas tij vendimi nuk është i bazuar në ligj për sa i përket llojit të masës së sigurimit. Gjykata ka argumentuar se masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” është masa më e përshtatshme në raport me nevojat e sigurimit që duhet marrë ndaj të dyshuarit S. Sh.

30.31 Gjykata ka argumentuar se: “ ... është i vërtetë fakti që personi nën hetim dyshohet për kryerjen e një vepre penale që parashikon vetëm dënim me burgim, por aktet mbi të cilat organi i prokurorisë mbështet dyshimin ndaj personit nën hetim, vlerësuar në raport dhe me provat e sjella nga mbrojtja janë mjaft të lëkundura... ”.

30.32 Sipas subjektit, me këtë arsyetim, rezulton se ka një kontradiktë, pasi nga njëra anë gjykata vë në dyshim ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në ngarkim të shtetasit S.Sh për konsumim të elementeve të veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” dhe nga ana tjetër cakton masë sigurimi qoftë kjo edhe detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Ky është një qëndrim i gabuar, pasi është në shkelje të hapur të kërkesave të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk mund të caktohet masë sigurimi në qoftë se në ngarkim të një

shtetasi nuk rezulton plotësisht e provuar ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm. Më pas subjekti bën një përmbledhje të rrethanave të faktit.

30.33 Në datën 16.7.2014, punonjësit e policisë Elbasan, kanë vënë nën vëzhgim të dyshuarin S.Sh dhe kanë konstatuar se i dyshuari ndodhej në banesën e tij në lagjen “5 Maj” të Elbasanit dhe rreth orës 15:00 te dera e banesës është afruar një person i quajtur F. M, i cili është takuar te dera e banesës me të dyshuarin dhe pasi ka qëndruar pak, është larguar. Punonjësit e policisë i janë prezantuar dhe kanë ushtruar kontroll fizik ndaj tij. Në xhepin e pantallonave i është gjetur një qese farmaceutike brenda së cilës gjendej një material bimor i ngjashëm me Cannabis Sattiva, që sipas deklarimit të tij, rezultoi se e bleu tek i dyshuari S. Sh në shumën 300 lekë. Punonjësit e policisë kanë shkuar në banesën e të dyshuarit, por ai ishte larguar. Në një distancë rreth 20 m larg banesës, punonjësit e policisë gjetën një qese farmaceutike me material bimor të ngjashëm me Cannabis Sattiva. Policia gjyqësore ka bërë ndalimin e të dyshuarit S.Sh në datën 19.7.2014. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin si masë sigurimi “arrest në burg” me afat 60 ditë. Afati u caktua me qëllim që organi i prokurorisë të bënte të mundur administrimin e aktekspertimit kimik të lëndës së sekuestruar dhe aktekspertimin toksikologjik-ligjor të monstrës së urinës së të dyshuarit. Në përfundim të këtij afati, prokuroria pasi ka administruar aktekspertimin kimik të lëndës dhe aktekspertimet toksikologjike-ligjore, është drejtuar me kërkesë gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” pa afat. Gjykata caktoi si masë sigurimi “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

30.34 Në vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2014, gjykata kishte argumentuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm, dyshim i cili vazhdon të jetë edhe në momentin e shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” pa afat. Deklarata noteriale e lëshuar nga shtetasi F.M dhe e administruar nga gjykata nuk ka vlerën e provës dhe, si e tillë, nuk duhej vlerësuar nga gjykata.

30.35 Në fund të aktit subjekti i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Durrës ndryshimin e vendimit nr.\*\*\* (\*\*\*\*), datë 19.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe caktimin si masë sigurimi ndaj shtetasit S. Sh “arrest në burg” .

30.36 Ky akt rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Akti është ndërtuar sipas standardit të një kërkesë të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese dhe argumentuese dhe në fund kërkimet dhe parashtrime të bazës ligjore.

**Dosja nr. \*\* Konkluzione për vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 2.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.**

30.37 Akti është i datës 23.1.2014, 1 faqe, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës, i përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti Moisi Duda, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

30.38 Subjekti paraqet vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*\*), datë 2.12.2011, ka vendosur: *Vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr.\*\*\*, datë 2.12.2009, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.*

Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili kërkonte ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës ankimore.

30.39 Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, procedimi penal nr. \*\*\* është pushuar. Ky procedim ishte regjistruar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”

parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasve N dhe K.B.

30.40 Subjekti argumenton se vendimi nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 2.12.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk është i bazuar në ligj. Gjykata nuk ka respektuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me njoftimin e palëve dhe konkretisht nenet 140 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale. Nga materialet e administruara në dosje rezulton se gjykata nuk i ka bërë asnjë njoftim personave ndaj të cilëve janë zhvilluar hetimet. Mosnjoftimi i këtyre shtetasve dhe zhvillimi i gjykimit pa praninë e tyre, përbën shkelje të rëndë procedurale, shkelje kjo e cila bazuar në germën “c”, të nenit 128/1, të Kodit të Procedurës Penale sjell pavlefshmërinë absolute të vendimit. Sipas subjektit, këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr.180, datë 9.4.2008, ka përcaktuar qartë se në gjykimet me objekte te tilla, njoftimi i të gjitha palëve që kanë interesa në proces është i domosdoshëm.

30.41 Në përfundim, subjekti i kërkon Gjykatës së Apelit Durrës prishjen e vendimit nr. \*\*(\*\*\*) , datë 2.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe kthimin e akteve për rigjykim në të njëjtën gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

30.42 Akti rezulton i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Akti është ndërtuar sipas standardit të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese dhe argumentuese dhe, në fund, kërkimet dhe parashtrime të bazës ligjore, mendimet dhe arsyetimet janë bërë në mënyrë të rrjedhshme.

30.43 Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

### **31. Analiza e gjetjeve**

#### ***Aftësitë profesionale***

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura, konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, lidhja e tyre me normat ligjore, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi bazueshmërinë ose jo të vendimeve të gjykatave.

#### ***Aftësitë organizative***

Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, gjatë 19 viteve të fundit ka qenë prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Durrës dhe nuk ka pasur si detyrë funksionale hetimin e çështjeve.

#### ***Aftësia për të administruar dosjet***

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përgatitjes së akteve me shkrim dhe paraqitjen e tyre në gjykatë. Etika në punë nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale.

Nga ankesa e analizuar sa më sipër, rezulton se nuk është gjetur ndonjë e dhënë që të tregojë se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit e lidhur me kohën e punës, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Moisi Duda, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

**Integriteti** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.

**Paanësia** Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Moisi Duda. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**Aftësitë e komunikimit** Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

**Aftësia për të bashkëpunuar** Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurorit Moisi Duda, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

**Gatishmëria për t'u angazhuar** Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti Moisi Duda rezulton gjatë kohës së rivlerësimit dhe më parë se ka marrë pjesë në dy trajnime në fushën penale, të organizuara në dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat u përshkruan më sipër.

**Komisioni nuk identifikoi problematika lidhur me kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit.**

### **Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale**

Trupi gjykues, bazuar: (i) në konstatimet e mësipërme dhe në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) në gjetjet e Këshillit të Lartë të prokurorisë, bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **DENONCIMET**

32. Në Komision janë protokolluar tri denoncime për subjektin e rivlerësimit duke u referuar ndërmjet disa subjekteve të tjera të rivlerësimit. Denoncimet paraqiten, si vijon:

32.1 Denoncim me nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2017, me denoncues A.E drejtuar ndaj 34 subjekteve, ndërmjet tyre edhe subjektit të rivlerësimit. Në këtë denoncim, subjekti ankohet lidhur me një konflikt që ka pasur denoncuesi, ndër vite, me shtetasen L. H, bashkortake në

një shoqëri tregtare “A”, e cila ka menaxhuar ndërtimin e një hidrocentrali në Librazhd, konflikti i cili ka degraduar ndër vite para organeve kompetente të Prokurorive dhe Gjykatave.

32.2 Lidhur me subjektin e rivlerësimit, denoncuesi e ka referuar, se subjekti ka favorizuar në mënyrë të qëllimshme çiftin H. Denoncuesi ka bashkëlidhur kopje me dokumente, lidhur me konfliktin e tij ndër vite. Komisioni e administroi dokumentacionin dhe u ndal në vlerësimin e aktit “rekurs” të lëshuar nga subjekti i rivlerësimit, ku konstatoi se denoncuesi është deklaruar fajtor nga gjykatat e të dy shkallëve (Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Apel Durrës) për kryerjen e veprës penale “mashttrim në kredi”, si dhe është dënuar me gjobë në vlerën 200.000 lekë. Nëpërmjet rekursit subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues i akuzës së Prokurorisë së Gjykatës së Apelit Durrës, nuk ka qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, pasi është marrë jo në bazë të ligjit në fuqi. Subjekti ka paraqitur arsyetimin pse nuk është dakord me llojin e dënimit, nisur nga rrezikshmëria e veprimeve të kryera nga i pandehuri, i cili ka mashtruar duke vepruar si ortak i vetëm i shoqërisë “A” sh.p.k. me qëllim përfitimin e një kredie në një shumë të konsiderueshme nga “Tirana Bank”, në kushtet kur ortak në këtë shoqëri ka qenë edhe shtetasja L.H.

32.3 Nëpërmjet kësaj kredie ka përfituar shuma parash, pa miratimin e ortakes tjetër e duke shkaktuar dëm ekonomik. Pra, rezulton se janë provuar veprimet e kryera nga i pandehuri nëpërmjet mashtrimit, me qëllim përfitimin. Subjekti ka vijuar arsyetimin se nisur nga fakti se neni 146 i Kodit Penal që parashikon veprën penale parashikon si dënim edhe atë me burgim deri në 7 vjet dhe nisur nga rrethanat dhe dëmi që i është shkaktuar, nga fakti që i pandehuri ka qenë i dënuar më parë, nga fakti që nuk e pranon akuzën etj., kërkon dënimin me burgim me 6 muaj.

32.4 Komisioni, pasi administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, duke përfshirë edhe rekursin dhe, pasi vlerësoi se subjekti i rivlerësimit në rekurs ka paraqitur faktet, rrethanat, arsyetimin pse duhet ndryshuar vendimi, bazuar në ligj, nuk gjeti shkak për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

32.5 Denoncimet e përsëritura, të paraqitura nga shtetasja R.Rr me nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.5.2019 drejtuar ndaj disa subjekteve përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Për subjektin e rivlerësimit denoncuesja ka pretenduar se ka qenë prokuror më shumë se një herë dhe ka kërkuar përjashtimin e tij. Denoncuesja ka bashkëlidhur vendimin nr. \*\*\* (\*\*), datë 6.3.2019, e Gjykatës së Apelit Durrës, ku prokurori ka përfaqësuar Prokurorinë e Apelit në çështjen gjyqësore me palë ankuese R.Rr me objekt kundërshtimin vendimin nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2018 në lidhje me kallëzimin penal drejtuar Prokurores së Përgjithshme, znj. A. M. Nga administrimi dhe vlerësimi i këtij akti nuk u gjetën *indicie* lidhur me subjektin e rivlerësimit.

32.6 Komisioni, duke konsideruar faktet e trajtuara në denoncim, kërkoi shpjegime të detajuara lidhur me veprimet procedurale në çështjen që ka trajtuar denoncuesja.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

32.7 Subjekti, në lidhje me denoncimet që ka bërë shtetasja R.Rr, ka sqaruar se nga materialet e procedimit penal që i përkasin vendimit nr. \*\*\*(\*\*), datë 6.3.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, rezulton se shtetasja R. Rr ka bërë kallëzim ndaj shtetasve E. M me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shtetasit G. M, oficer i policisë gjyqësore për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 250 dhe 251 të Kodit Penal. Kallëzimin ia ka drejtuar Prokurores së Përgjithshme, znj. A.M. Nga Prokuroria e Përgjithshme, kallëzimi i shtetasve R.Rr i është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila e ka regjistruar datë 15.10.2018. Me vendimin e datës 31.10.2018, prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk



parashikohet nga ligji si vepër penale. Ndaj këtij vendimi, shtetasja R.Rr ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. (\*\*\*\*)\*\*\*\*, datë 18.1.2019 ka vendosur mospranimin e kërkesës ankimore. Shtetasja R. Rr ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Durrës ndaj vendimit nr. (\*\*\*\*)\*\*\*\*, datë 18.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në bazë të shortit të datës 14.2.2019, kjo çështje i është caktuar subjektit për ta përfaqësuar në Gjykatën e Apelit Durrës.

32.8 Ne seancë gjyqësore datë 6.3.2019, të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës, shtetasja R.Rr është shprehur se ka qenë ky prokuror që e ka marrë në patronazh. Pavarësisht këtij deklarami, nuk ka pasur shkak për heqje dorë nga përfaqësimi i kësaj çështjeje, pasi nuk ekzistonte asnjë nga kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nuk ka pasur ndonjë arsye njëanësie të parashikuara në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale që të kërkonte sipas kërkesave të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale heqjen dorë nga përfaqësimi i kësaj çështjeje. Pavarësisht se ka përfaqësuar disa çështje në Gjykatën e Apelit Durrës me palë ankuese shtetasen R. Rr, nuk ka pasur asnjë shkak ligjor për të hequr dorë, pasi çështjet nuk i përkisnin të njëjtit fakt penal, por lidheshin me fakte të ndryshme penale.

32.9 Pavarësisht deklaramit që kjo shtetase bëri në seancë gjyqësore, nuk i kërkoi Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, zëvendësimin e subjektit me prokuror tjetër, e drejtë kjo e parashikuar në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale.

32.10 Në konkluzionet e tij, subjekti ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. (\*\*\*\*)\*\*\*\*, datë 18.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.\*\*\*\*(\*), datë 6.3.2019, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. (\*\*\*\*)\*\*\*\*, datë 18.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

32.11 Subjekti sqaron se në Gjykatën e Apelit Durrës janë gjykuar disa çështje me palë ankuese shtetasen R. Rr dhe në gjykimin e këtyre çështjeve kanë marrë pjesë pothuajse të gjithë prokurorët e Prokurorisë së Apelit Durrës.

32.12 Referuar shpjegimeve të mësipërme subjekti ka bindjen se në gjykimin e çështjes me palë ankuese shtetasen R.Rr, që i përket vendimit nr. \*\*\*\*(\*\*\*\*), datë 6.3.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, përfaqësimi i tij ka qenë sipas rregullave procedurale dhe se denoncimet e saj nuk kanë asnjë bazë ligjore.

32.13 Komisioni analizoi denoncimin e mësipërm, shpjegimet e dhëna, provat e paraqitura nga subjekti arriti në përfundimin se në këtë denoncim nuk ka *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Moisi Duda, ka plotësuar së bashku kushtet:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar,

në bazë të nenit 51, nenit 58, germa “a”, e pikës 1, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Moisi Duda, prokuror në Prokurorinë e Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë më 16.9.2020.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**

**Kryesues**

**Xhensila PINE**

**Relatore**

**Brunilda BEKTESHI**

**Anëtare**

Sekretare gjyqësore  
Etmonda Hoxha